



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

---

Numri i lëndës: 2022:149525  
Datë: 28.03.2024  
Numri i dokumentit: 05520059

C.nr.2022:149526

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Mirlinda Bytyqi Rexhepi, në çështjen juridike të paditësve A.Sh. nga fshati ... Komuna Ferizaj dhe K.K. nga Ferizaj, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson av.Visar Musa nga Ferizaj kundër të paditurit H.P.SH.P.K me adresë në fshatin ....., Komuna Ferizaj, të cilin e përfaqëson me autorizim av.Arber Guta nga Prishtina, në çështjen juridike kompensim dëmi, jashtë seancës gjyqësore me dt. 28 mars 2023 mori këtë:

A K T V E N D I M

NDËRPRITET PROCEDURA në këtë çështje juridike të paditësve A.Sh. nga fshati ... Komuna Ferizaj dhe K.K. nga Ferizaj, kundër të paditurit H.P.SH.P.K me adresë në fshatin ....., Komuna Ferizaj në çështjen juridike për kompensim dëmi, për shkak të zgjidhjes së çështjes paraprake.

Paditësi udhëzohet se mund ta kërkojnë vazhdimin e procedurës kontestimore pas plotësimit të kushteve ligjore sipas nenit 280 të LPK-së.

A r s y e t i m

Paditësit A.Sh. nga fshati ... Komuna Ferizaj dhe K.K. nga Ferizaj,, përmes të autorizuarit të tij av.Visar Musa kanë ushtruar padi kundër të paditurit H.P.SH.P.K me adresë në fshatin ....., Komuna Ferizaj, për çështjen juridike kompensim dëmi, në gjykatë me 22.07.2022. I autorizuari i paditësit me datën 25.03.2024 ka dorëzuar në gjykatë një parashtrësë me të cilën i ka propozuar gjykatës që konform nenit 278 të LPK-së të ndërprehet procedura kontestimore për

shkak të zgjidhjes së çështjes paraprake meqenëse është duke u zhvilluar një procedurë penale e në prokurori e cila ndërlidhet me këtë padi.

Gjykata konform nenit 278 par.1 të LPK-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke ndërprerë procedurën për shkak të zgjidhjes së çështjes paraprake.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

C.nr.2022:149526 më datë 28 mars 2024

Gjyqtarja

Mirlinda Bytyqi Rexhepi

**KËSHILLA JURIIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit Prishtinë përmes kësaj Gjykate.